



**Republika e Kosovës**  
**Republic of Kosova**



**Komuna Hani i Elezit**  
**Municipality of Hani Elezit**

### Zyra e transparencës

Me qëllim të përmbushjes të objektivave që dalin nga Rregullorja e Transparencës dhe në mënyrë që zhvillimet në Komunë të pasqyrohen në mënyrë sa më të mirë të mundshme si para qytetarëve të komunës ashtu edhe para opinionit sa më të gjerë zyra, e transparencës ka planifikuar një varg të aktiviteteve që ti realizoj këto qëllime;

- Takimet me qytetarët do të mbahen rregullisht dhe së paku dy here brenda vitit (sipas statutit të komunës së Hanit të Elezit), një në gjashtëmujorin e parë dhe një në fund të vitit. Në raste të nevojës , mund të ketë edhe më tepër.
- Orari, data e mbajtjes së takimeve, pastaj vendi se ku do të mbahen, po kështu edhe çështjet që do të trajtohen do të bëhen publike.
- Informacionet lidhur me këto dëgjime do t'u distribuohen medieve dhe ato të vendosen në Web- faqen zyrtare të Komunës, shpalljet në vende të dukshme në ndërtesën e vet Kuvendit Komunal . Ftesa për pjesëmarrje në këto takime i bëhet qytetarëve , përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe të medieve .
- Dëgjimet publike buxhetore do të organizohen sipas rregullores së MEF-it dhe kërkesës së shoqërisë civile . Ftesa për pjesëmarrje në këto takime i bëhet qytetarëve përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe të medieve.
- Krahas dëgjimeve publike strukturat komunale janë të obliguara që të bëjnë publike raportet periodike financiar për të hyrat buxhetore dhe për shpenzimet publike. Publikimi i raporteve do të bëhet në Web- faqe..
- Krahas konferencave të rregullta për shtyp (6 mujore)të kryetarit të komunës, Bordi i Drejtorëve Komunalë duhet të mbajë së paku 2 takime publike me qytetarë duke siguruar që objekti i mbajtjes së takimeve të mundësojë pjesëmarrje të konsiderueshme të qytetarëve të interesuar dhe atë, në periudha gjashtë mujore, për t'i raportuar publikut ecuritë e punës së tij dhe për t'i komunikuar planet për gjashtë mujorin vijues.

- Njohja publike e ndikimit të vendimeve buxhetore do të ndihmohet duke publikuar dokumente dhe broshura nga zyra për informim e komunës së Hanit të Elezit( sipas mundësive buxhetore).
- Do të publikohen raportet periodike mbi grumbullimin e të hyrave vetanake dhe shpenzimeve, si dhe t'i dorëzojë publikut informimin mbi të gjitha veprimet financiare publike .
- Publikimi i gjithë tenderëve komunal, do të bëhet përmes Eëb- faqes së komunës, , Mundësimi i grupeve të shoqërisë civile të marrin pjesë dhe të monitorojnë procedurën e hapjes së tenderëve.
- Zyra e transparencës do të angazhohet që të ofrojë mundësinë që Organizatat e Shoqërisë Civile të vëzhgojnë procesin dhe korrektësinë në zgjedhjen e ofertuesve si dhe publikimin dhe shpalljen e të gjitha rezultatet dhe prokurimeve komunale
- Shpallja e emrave dhe rezultateve të ofertuesve/ndërmarrjeve për secilin vlerësim të tenderit.
- Do të siguron transparencë në procedurat e shpalljes së konkurseve si dhe do të bën publike shpalljet për vendet e lira të punës në hyrje të ndërtesës së Kuvendit Komunal shtypin ditorë dhe në Eëb- faqen zyrtare (në tabelën informative),
- Do të njoftojnë publikun e gjerë se aktet, rregulloret dhe vendimet e Kuvendit Komunal ose organeve të tjera komunale u nënshtrohen diskutimit publik para se të miratohen.
- Të gjitha Raportet, vendimet, rregulloret do të publikohen në Eëb faqen e komunës.
- Sipas udhëzimit administrativ, Zyra për informim do harton edhe formularë të kërkesës për qasje në dokumente zyrtare dhe do të ndihmon qytetarët për të plotësuar kërkesën për qasje. Formulari do të jetë i unifikuar ashtu si precizohet në Udhëzim ( duhet të përmbajë: Emrin dhe adresën e personit kërkuesit, Datën, Objektin e kërkesës, Formën që kërkohet dokumenti, numrin e kopjeve të kërkuara)
- Lobimi për qasjen në dokumentet zyrtarë dhe shpërndarja e informacioneve lidhur me vendimet që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e banorëve në komunë do të jenë detyra të përhershme të secilit zyrtar në komunë, pavarësisht se a është fjala për pjesëtarë të stafit politik apo civil.
- Përdorimin aktiv të Web- faqes zyrtare dhe krijimi i mundësive për komunikimin elektronik me qytetarët.
- Publikimi i informatorëve, buletineve, e raporteve dhe shpërndarja e tyre nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit.( varësisht prej mundësive buxhetore)
- Mediat do të njoftohen më së paku 14 ditë paraprakisht për takimet publike me qytetarët.
- Mediet do të pajisen paraprakisht me rendin e ditës rreth asaj se çka do të diskutohet në takimet me qytetarë .Mediet do të njoftohen për mundësinë e qasjes në raportet komunale dhe vendin ku mund të pajisen me këto dokumente.
- Përpilimi dhe publikimi i broshurave ( sipas mundësive buxhetore), zhvillimin e fushatave në bashkëpunim më shoqërinë civile, apo mbështetja e shoqërisë civile (mundësisht) në aspektin financiar për organizimin e tyre
- Njoftimi me kohë për të gjitha aktivitetet që do të organizohen në institucionet komunale nëpërmjet debateve, konferencave për shtyp, shpërndarjes së buletineve informativë, komunikatave dhe raporteve
- Zyra për transparencë ka tashmë një listë kontaktuese për të gjitha mediet në Kosovë për të shpërndarë të gjitha njoftimet për takime, konferenca për shtyp dhe të gjitha

informatat e tjera .Do të përgjigjet në kërkesat specifike të medieve në lidhje me çështjet dhe zhvillimet në komunës.

- Do të përcjell dhe do të informoj për të gjitha takimet zyrtare të organeve komunale.  
**-Meqenëse zyra për transparencë kushtëzohet edhe nga zhvillimet dhe ngjarjet ditore kjo zyre do të mundohet që të gjitha këto zhvillime të jenë plotësisht transparente.**